

Hapet thirrja për aplikim për bursa në programin Mevlana Exchange, për studentët dhe stafin akademik për mësimdhënie, për vitin akademik 2019-2020, në universitetin Kocaeli, Turqi

Në kuadër të programit Mevlana Exchange është hapur thirrja për aplikim për bursa shkëmbimi për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020. Mevlana Exchange Programme është një program i cili mundëson shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Kocaeli.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;
- Master;
- Doktoraturë;

Llojet e mobilitetit për stafin:

- Staf akademik për mësimdhënie;

Kohëzgjatja e bursave për studentët:

- 4 muaj;

Kohëzgjatja e bursave për stafin akademik:

- 2 javë;

Për t'u njohur me fushat e studimit ju lutem referohuni linkut:

<http://mevlana.kocaeli.edu.tr/Dosyalar/Belgeler/MevlanaAlanKodlari.pdf>

Dokumentacioni për aplikim për studentët:

Dokumentat e nevojshme për aplikim mund të shkarkohen në linkun:

http://mevlana.kocaeli.edu.tr/index_en.php?enpages=page&id=documents

Dokumentacioni për aplikim për stafin:

Dokumentat e nevojshme për aplikim mund të shkarkohen në linkun:

http://mevlana.kocaeli.edu.tr/index_en.php?enpages=page&id=documents

Kompensimi financiar për studentët:

- Bursa për studentët është 1000 TL (Turkish Lira) për çdo muaj
- Biletë udhëtimi (2500 - 4000 TL)

*Studentët paguajnë pagesën e shkollimit në universitetin e vendit të tyre, pra ku ata janë regjistruar dhe nuk paguajnë asnjë pagesë tjetër shkollimi në universitetin pritës.

Kompensimi financiar për stafin:

- Kompensim ditor për stafin (40 - 50 TL/ditë)
- Biletë udhëtimi (2500 - 4000 TL)

Afati i aplikimit: 15 Shkurt 2019

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!